

VENDIM
Nr. 249, datë 13.12.2021

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 111, DATË 26.4.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË ‘E-VENTO SRL ALBANIA’ SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 32, DATË 4.2.2021, ‘MBI KËRKESËN E SHOQËRISË ‘E-VENTO SRL ALBANIA’ SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 84, DATË 17.7.2008, TË NDRYSHUAR”

(ndryshuar me vendimet nr. 269, datë 14.10.2022, nr. 357, datë 30.12.2022; nr. 210, datë 27.6.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 2 dhe 3, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 151/7 prot., datë 10.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rishikimin e vendimit nr. 111, datë 26.4.2021, ‘Mbi kërkesën e shoqërisë ‘E-Vento s.r.l. Albania’ sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021, ‘Mbi kërkesën e shoqërisë ‘E-Vento s.r.l. Albania’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 111, datë 26.4.2021, vendosi:

“1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë ‘E-Vento s.r.l. Albania’ sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021, sipas kushteve të cituara në këtë vendim, me objekt rishikimi nga ERE pas përfundimit të afatit 3-mujor.”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE ka njoftuar shoqërinë duke i sjellë në vëmendje detyrimin për të plotësuar brenda afateve dokumentacionin e kërkuar në këtë vendim.

- Brenda afatit të vendosur në vendimin nr. 111/2021, shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k. ka përcjellë argumente dhe dokumentacion, në lidhje me plotësimin e kushteve të këtij vendimi.

- Nga shqyrtimi paraprak i këtij dokumentacioni, rezultoi se shoqëria kishte referuar se është në proces për t’u pajisur me dokumentacionet përkatëse nga organe të tjera shtetërore, siç janë bashkitë, në lidhje me dokumentet e pronësisë, apo Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), në lidhje me lejen mjedisore, ndaj ERE i dërgoi shkresa këtyre institucioneve për të marrë një informacion të saktë në lidhje me fazën në të cilën ndodhet pajisja me këto dokumente apo leje.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 219, datë 27.10.2021, vendosi të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen, në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimit të Bordit nr. 111, datë 26.4.2021.

Në zbatim të urdhrit të kryetarit të ERE-s nr. 79, datë 9.11.2021, në datën 22.11.2021, në ambientet e ERE-s është zhvilluar seanca dëgjimore me përfaqësuesin e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., i cili ka sqaruar/argumentuar mbi dokumentacionin e depozituar dhe plotësimin e kushteve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 111/2021.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3.1, të vendimit nr. 111/2021, ku përcaktohet se shoqëria duhet të depozitonte në ERE, brenda 3 muajve, studimin e fizibilitetit, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit, duke përcaktuar në këtë studim koston e prodhimit të energjisë elektrike, të shoqëruar dhe me grafikun e rishikuar të punimeve, shoqëria, gjatë seancës dëgjimore dhe me shkresën e dërguar në vijim të saj, ka deklaruar se ka marrë ofertë zyrtare për vendosjen e anemometrave duke marrë të dhënat përfundimtare të studimit të erës, që do të shërbejnë për hartimin e studimit të fizibilitetit. Shoqëria ka kërkuar një afat prej 14 muajsh (12 muaj për matje të erës nga momenti i vendosjes së anemometrave dhe 2 muaj për

hartimin e studimit të fizibilitetit). Në lidhje me afatin e kërkuar vlerësohet se është i mjaftueshëm afati prej 12 muajsh, pasi studimi i fizibilitetit mund të hartohet njëkohësisht me marrjen e të dhënave nga matja e shpejtësisë së erës.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3.2, të vendimit nr. 111/2021, që ka të bëjë me lejen mjedisore, shoqëria ka dokumentuar në ERE aplikimin e bërë në sistemin *online*, e-Albania, në datën 16.8.2021, së bashku me të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe bën me dije se është në pritje të pajisjes me lejen mjedisore, pasi janë ezauruar të gjithë hapat procedural teknik në sistemin elektronik të e-Albania. Në lidhje me këtë kusht, sa dokumentuar nga shoqëria për kryerjen e aplikimit për rinovimin e lejes mjedisore, është konfirmuar dhe nga vetë AKM-ja.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 4, germa “a”, të vendimit nr. 111/2021, që ka të bëjë me dokumentacionin ligjor vërtetues, mbi realizimin e investimeve për zbatimin e projektit eolik, konstatohet se shoqëria e ka plotësuar pjesërisht këtë kusht, me depozitimin e bilanceve dhe të shlyerjes së disa pagesave. Në kuadër të përditësimit periodik të ecurisë së kushteve shoqëria duhet të depozitojë dhe dokumentacionin përkatës vërtetues për realizimin e investimeve.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 4, germa “b”, të vendimit nr. 111/2021, që ka të bëjë me dokumentacionin pronësor për të gjithë sipërfaqen e nevojshme, për realizimin e projektit, shoqëria ka deklaruar se ka filluar punën për rinovimin/lidhjen e kontratave të reja të qirasë, për të gjithë sipërfaqen ku do të zhvillohet projekti, por në bazë të legjislacionit në fuqi, duhet të bëhet regjistrimi i kontratave të qirave pranë drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK), por kjo zonë nuk është hedhur ende në sistemin e digjitalizuar kadastral. Shoqëria ka vendosur ta kryejë vetë këtë proces nëpërmjet shoqërisë së projektimit dhe supervizionit Zenit & Co sh.p.k. dhe për të përfunduar të gjithë procedurën, sipas përcaktimeve përkatëse ligjore, ajo deklaron se i nevojitet një afat kohor prej 12 muajsh.

Sa më sipër përcjellë e dokumentuar nga shoqëria, rezulton se nuk është depozituar ende dokumentacioni pronësor për të gjithë sipërfaqen e projektit siç kërkohet specifikisht në këtë kusht. Për sa i takon afatit të kërkuar nga shoqëria, vlerësojmë se duhet t’i lihet në dispozicion një afat kohor prej 9 muajsh, duke konsideruar se bashkitë janë shprehur se afati procedural për rinovimin/lidhjen e kontratës së re është 6 muaj nga momenti i fillimit të procedurave. Përveç kësaj, vlerësohet t’i lihet shoqërisë një afat kohor prej 3 muajsh për përgatitjen e dokumentacionit topografik në formatin e kërkuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

- Si përfundim, shoqëria është shprehur se afatet konkrete të kërkuara nga ana e saj për plotësimin e secilit kusht, janë të përafërta dhe se ajo kërkon një shtyrje afati total prej 36 muajsh, afat ky që do t’i japë siguri me investitorin e huaj. Në lidhje me këtë pretendim, vlerësohet se afati nuk është i justifikuar, pasi jo të gjitha kushtet janë komplementare të njëra-tjetrës dhe afati nuk mund të kërkohet në mënyrë kumulative, ndaj ERE ka vlerësuar dhe arsyetuar zgjatjen konkrete për plotësimin e secilit kusht, konkretisht 12 muaj për depozitimin e studimit të fizibilitetit dhe 9 muaj për depozitimin e lejes së mjedisit dhe dokumentacionit përkatës pronësor, si dhe përditësimin periodik me dokumentacionin përkatës vërtetues për realizimin e investimeve.

- Referuar faktit që shoqëria ka filluar procedurat për plotësimin e këtyre kushteve, vlerësohet t’i lihet detyrimi që të informojë/dokumentojë në ERE çdo muaj ecurinë e plotësimit të tyre. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me përditësimin e plotësimit të kushteve nga shoqëria, apo akteve ligjore apo nënligjore të dala nga organet e tjera.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shoqëria, deri më 31.12.2023, të depozitojë në ERE studimin e fizibilitetit.
2. Të zgjasë me 3 (tre) muaj afatin e depozitimit të deklaratës mjedisore dhe me 6 (gjashtë) muaj afatin e depozitimit të dokumentacionit pronësor duke filluar ky afat nga data 15.12.2022.

3. Shoqëria "E-Vento s.r.l. Albania" sh.p.k., çdo 3 (tre) muaj një progresraport me informacion për investimet që do të kryejë, në kuadër të plotësimit të kushteve të sipërcituara.

4. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me informacionin/dokumentacionin e përditësuar sipas pikës 3, të këtij vendimi, apo aktet ligjore apo nënligjore të dala nga organet e tjera.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë kërkuuesin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti